



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Tetor 2018

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Nentor

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Tetor 2018

© Ministria e Financave, 2018

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: vivi.besho@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Tetor 2018 arriti në 105.03 për qind;*
- *Norma vjetore e inflacionit për muajin Tetor 2018 ishte 1.9 për qind;*
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Tetor 2018 ishte 108.99 lekë për dollarë dhe 125.21 lekë për euro;*
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Tetor 2018 shënuan kuotën 0.77 për qind për ato 12 –mujore; 0.45 për qind për depozitat 6-mujore; 0.28 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.77 për qind për depozitat 1-mujore;*
- *Normat e interesit për huatë në lekë ishin 4.70 për qind për huatë 12-mujore dhe 8.23 për ato 6-mujore;*
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.248.688 milionë lekë në muajin Tetor, duke shënuar një rënie prej rreth 0.1 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;*
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2018-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 154.8 milionë euro.*
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar-Tetor 2018 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 1.4 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar deficit prej 6.3 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës Janar-Tetor 2018, arritën në rreth 370.005 miliardë lekë ose afërsisht 98% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 368.555 miliardë lekë ose 96% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*

Zhvillimet Ekonomike


1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Tetor 2018 ishte +1.9%. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +1.9%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Tetor 2018 shënoi rënie prej 0.2 për qind krahasuar me muajin paraardhës, në muajin shtator pati rritje prej 0.2 për qind. Përgjatë muajit gusht 2018, indeksi ka shënuar rënie prej 0.4 për qind në krahasim me muajin paraardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Tetor 2017 nuk kishte ndryshim në krahasim me muajin paraardhës.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Transporti” me 4,3 %, pasuar nga grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 3,4 %, “Argëtim dhe kulturë” me 3,2 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” dhe “Pije alkoolike dhe duhan” me 1,8 % secili, “Hotele, kafene dhe restorante” me 1,0 %, “Shërbimi arsimor” me 0,8 % “Komunikimi” me 0,7 %, etj.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoria e



“Shëndetit”, ka ndikuar negativisht në inflacionin e përgjithshëm përgjatë muajit Tetor 2018.

Ndryshimi mujor i indeksit është -0.2%. Krahasuar me muajin Shtator 2018, grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” dhe “Pije alkoolike dhe duhan” shënuan një ulje prej 1,0 % secili. Ndërsa, grupi “Transporti” u rrit me 0,8 %, pasuar nga “Veshje dhe këpucë” me 0,7 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Shërbimi arsimor” me 0,6 % secili, “Mobilje, paisje shtëpie dhe mobilime” me 0,2 %.

Tab - 1 **Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)**

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2017	2.8	2.2	2.1	1.9	2.0	2.2	2.0	1.6	1.6	1.9	1.7	1.8
2018	1.7	2.1	2.0	2.1	2.1	2.4	2.3	2.2	2.1	1.9		


Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Tetor 2018, arriti në 125.21 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 1.0 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Tetor, një euro u këmbye me 124.94 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Tetor 2018 arriti në 108.99 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 0.52 për qind kundrejt muajit shtator 2018. Në fund të muajit Tetor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 110.25 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Tetor të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 6.32 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 4.18 për qind. Forcimi i lekut në dy vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të rrezikut për ekonominë tonë.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.87 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Tetor 2018, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 1 mujore shënuan vlerën më të lartë prej 0.77 për qind secila, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3-mujore që arritën përkatësisht kuotën 0.45 dhe 0.28 për qind.


Normat e interesit të depozitave 12 dhe 1-mujore kanë shënuar rritje mujore respektivisht prej 0.13 dhe 0.10 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të depozitave 6 dhe 3-mujore kanë pësuar rënie prej përkatësisht 0.04 dhe 0.01 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6 dhe 3 mujore, kanë pësuar rënie prej përkatësisht 0.04, 0.09, 0.02 ndërsa ato me afat maturimi 1 mujore nuk kanë patur ndryshim.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12-mujore gjatë muajit Tetor 2018 arritën përkatësisht kuotën prej 8.23 dhe 4.70 për qind. Normat e interesit të huave 12-mujore kanë shënuar rënie mujore prej 1.47, ndërsa huatë 6-mujore kanë shënuar rritje prej 1.07 për qind. Ndërsa krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12-mujore kanë shënuar përkatësisht rritje prej 0.84 dhe rënie 1.95 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Tetor 2018 arritën nivelin 1.65 për qind duke shënuar kështu rënie mujore prej 0.02 për qind dhe rënie vjetore prej 0.81 për qind.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot



Burimi: Banka e Shqipërisë

4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të vitit 2018 shënoi rritje të mjeteve valutore, me rreth 154.8 milionë euro. Tremujori i tretë i 2018-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 146 milionë euro, dhe vlerësohet lehtësisht në terma vjetore (rreth 3%). Deficiti tregtar u ngushtua me rreth 3%, në nivelin 361 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 124 milionë euro në rënie me 11 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Flukset e kapitalit, shumat e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion prej rreth -142.8 milionë euro. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 3.324 milionë euro dhe janë zgjeruar me 9% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 146 milionë euro, në rritje vjetore me rreth 3%. Ecuria e deficitit korrent në këtë tremujor, reflekton balancën negative të të ardhurave parësore, ndërkohë që, vijon axhustimi deficitit tregtar në mallra. Në të njëjtën kohë, suficiti i të ardhurave dytësore është zgjeruar në drejtim të rritjes së transfertave hyrëse drejt sektorëve të tjerë. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për tremujorin e tretë 2018 (Fig-6):

- (i) bilanci tregtar me -740.6 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 379.9 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -18.5 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 232.7 milionë euro.





5. Mjetet Valutare Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Tetor 2018, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 25.422 milionë lekë krahasuar me muajin Tetor të vitit 2017. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto bankës qendrore me rreth 33.601 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 31.164 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 26.084 milionë lekë të bankës qendrore.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1.248.688 milionë lekë në muajin Tetor 2018, duke shënuar rënie prej rreth 1.269 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rënie vjetore prej 0.1 për qind.

Në muajin Tetor 2018, sistemi bankar rezulton me rënie prej 5.602 milionë lekë ose -0.4 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Tetor 2018 arriti në rreth 532.522 milionë lekë. Balanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rënie me vlerë 19.809 milionë lekë, ose rënie prej rreth 3.6 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (50.5%) dhe monedhave të huaja (49.5%).

Gjatë muajit Tetor 2018, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 60.2 për qind ose 319.514 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.5 për qind ose 183.453 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.62 dhe 1.81 për qind apo 19.292 dhe 9.617 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin Tetor 2018, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 72.0 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 25.0 për qind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me rreth 1.98 për qind dhe rreth 1.16 për qind.



7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 265.433 milionë lekë në fund të muajit Tetor 2018. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Tetor 2018 ka shënuar rënie mujore prej 0.17 për qind si dhe rritje vjetore prej 0.89 për qind, duke arritur nivelin 21.3 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rënie mujore prej 0.28 për qind dhe rritje vjetore prej 1.41 për qind, duke shënuar nivelin 27.0 për qind.


Fig-11



Raportet të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat
Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Tetor 2018, kanë pësuar rritje prej 1.9 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 80.8 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa depozitat në Lekë gjatë muajit Tetor 2018 shënuan rënie prej 14.062 milionë lekë në krahasim me muajin Tetor 2017. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 82.8 për qind të tyre.

Fig-12



Raporti i Depozitave ndaj M3
Burimi: Banka e Shqipërisë


8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Tetor 2018, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 82.8 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 12.5 për qind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.5 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 80.8 për qind dhe rreth 17.3 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 81.7 për qind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 803.609 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (148.572 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (14.826 milionë lekë) dhe “Korporata jofinanciare publike” (14.570 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.677 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Tetor 2018, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 983.255 miliardë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 2.248 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rënie me 12.067 milionë lekë.


Fig-13



Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-14



Përberja e depozitave Tetor 2018

Burimi: Banka e Shqipërisë


Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar-Tetor 2018 janë mbledhur rreth 370.005 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 368.555 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 318.437 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 49.9 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 39% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 250.9 miliardë lekë (ose rreth 98% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushtetit vendor rreth 17.3 miliardë lekë (ose rreth 107% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 77.2 miliardë lekë (ose rreth 100% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 19.0 miliardë lekë (ose rreth 90% e planit të periudhës Janar-Tetor 2018).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 318.4 miliardë lekë, 60.8 miliardë lekë (19% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 29.7 miliardë



lekë (9%) për shpenzime interesi, 32.9 miliardë lekë (10%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 752 milionë lekë (0.2%) për subvencione, 132.7 miliardë lekë (42%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 42.6 miliardë lekë (13%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 16.6 miliardë lekë (5%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 70% (shpenzime personeli), 56% (shpenzime për interesat), 62% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 29% (subvencione), 72% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 83% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 66% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 55%, ndërsa financimi i huaj është 61% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Tetor 2018 ishin rreth 370.005 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 346.617 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 19.007 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat gjatë muajit Tetor 2018 (mld Lekë)
Revenues during October 2018 (in billion ALL)

Burimi (Source)	Tetor '18 October '18	Tetor '17 October '17	Ndrysh(%) Chang (%)
TVSH (VAT)	13.1	12.5	10.9
Taksa doganore (Custom Tax)	0.5	0.5	-4.2
Akcizat (Excise)	3.8	3.5	8.8
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	2.6	1.8	41.4
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	3.0	2.4	21.5
Taksat nacionale (National Tax)	3.0	2.7	11.1

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Tetor – 2018

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: October – 2018

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 1.4 milionë lekë gjatë periudhës Janar-Tetor 2018, u përdor kryesisht për huamarrjen e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe për huanë afatgjatë të huaj.

Për muajin Tetor 2018, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 40.783 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 42.567 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Tetor 2018, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 37.3 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 36.9 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 5.4 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2014	2015	2016	2017	2018	2014	2015	2016	2017	2018	2014	2015	2016	2017	2018	
Janar	0.8	1.4	0.9	1.5	1.5	0.8	1.4	0.9	1.5	1.5	1.7	1.3	1.5	2.8	1.7	January
Shkurt	1.4	2.4	1.1	0.5	0.8	1.1	1.9	1.0	1.0	0.9	1.9	2.3	0.2	2.2	2.1	February
Mars	0.5	0.4	0.5	0.4	0.3	0.9	1.4	0.8	0.8	0.9	2.2	2.2	0.3	2.1	2.0	March
Prill	-0.6	-0.5	-0.4	-0.6	-0.5	0.5	0.9	0.5	0.5	0.7	1.7	2.3	0.3	1.9	2.1	April
Maj	-1.1	-1.6	-1.2	-1.2	-1.2	0.2	0.3	0.2	0.1	0.2	1.6	1.8	0.7	2.0	2.1	May
Qershor	-0.7	-1.1	-0.6	-0.4	-0.1	0.1	0.1	0.04	0.0	0.1	1.5	1.4	1.2	2.2	2.4	June
Korrik	-0.6	-0.7	0.05	-0.14	-0.3	0.0	0.1	0.17	0.0	0.1	1.8	1.3	1.9	2.0	2.3	July
Gusht	0.1	0.8	0.86	0.41	0.4	0.0	0.1	0.19	0.1	0.1	2.0	1.9	2.0	1.6	2.2	August
Shtator	0.3	0.6	0.40	0.36	0.2	0.0	0.2	0.17	0.1	0.1	1.5	2.2	1.8	1.6	2.1	September
Tetor	0.1	0.01	-0.2	0.0	-0.2	0.0	0.1	0.13	0.1	0.1	1.4	2.1	1.5	1.9	1.9	October
Nëntor	-0.2	-0.3	0.1	-0.1		0.0	0.1	0.12	0.1		1.7	2.1	1.9	1.7		November
Dhjetor	0.7	0.6	0.9	1.0		0.1	0.17	0.19	0.2		0.7	2.0	2.2	1.8		December

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Tab - 2 Kursi i këmbimit
Exchange rate

Monedha	2014	2015	2016	2017	2018										Currency	
					Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor		
					January	February	March	April	May	June	July	August	September	October		
<i>Mesatarja e periudhës</i>																<i>Average of period</i>
USD	113.64	126.64	128.29	112.56	109.52	107.39	106.43	105.30	107.42	107.77	107.73	108.83	108.42	108.99		USD
EURO	140.11	137.65	135.27	133.25	133.57	132.72	131.27	129.28	126.98	125.95	125.86	125.66	126.47	125.21		EURO
<i>Fundi i periudhës</i>																<i>In the end of period</i>
USD	115.23	125.79	128.17	111.10	107.26	108.12	105.80	106.28	107.61	108.13	107.27	108.19	108.75	110.25		USD
EURO	140.14	137.28	135.23	132.95	133.44	132.23	130.44	128.74	125.92	125.93	125.76	126.27	126.29	124.94		EURO

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2014	2015	2016	2017	2018										Tetor October	In percent	
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September				
Norma e depozitave																	Deposits rates
12-M	1.51	1.27	0.78	0.80	0.72	0.80	1.03	0.77	0.75	0.79	0.71	0.56	0.64	0.77	0.77	0.77	12-M
6-M	1.16	1.17	0.78	0.56	0.69	0.75	0.55	0.52	0.56	0.67	0.49	0.60	0.49	0.45	0.45	0.45	6-M
3-M	0.83	0.54	0.27	0.29	0.28	0.25	0.27	0.26	0.27	0.29	0.30	0.28	0.29	0.28	0.28	0.28	3-M
1-M	1.47	0.88	0.87	0.82	0.92	0.76	0.93	0.91	0.64	0.72	0.80	0.59	0.67	0.77	0.77	0.77	1-M
Norma e huasë																	Lending rates
12-M	7.00	7.47	4.54	6.79	6.65	6.51	6.84	4.14	5.86	5.22	6.41	6.15	6.17	4.70	4.70	4.70	12-M
6-M	8.18	8.35	7.01	8.12	10.14	8.52	8.01	7.71	6.58	8.33	7.89	8.89	7.16	8.23	8.23	8.23	6-M
Norma e letrave me vlerë																	Securities rates
Bono thesari 1/																	Treasury bills 1/
3-M	3.15	-	-	-	1.31	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3-M
6-M	3.16	2.46	2.00	-	-	2.04	-	1.84	1.92	-	-	1.36	-	1.34	1.34	1.34	6-M
12-M	3.33	2.40	2.92	2.63	2.71	2.62	2.51	2.36	2.26	2.07	1.82	1.68	1.67	1.65	1.65	1.65	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2018

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2018

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	35,391	67,555	105,295	143,156	180,009	217,029	256,035	293,799	329,222	370,005	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	92	365	325	670	1,393	1,726	2,005	2,296	2,727	4,381	Grants
II.	Të ardhura tatimore	33,116	63,182	98,456	134,346	168,104	202,245	239,615	275,731	309,290	346,617	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	22,858	45,099	72,131	96,027	120,885	145,553	172,327	199,530	224,378	250,923	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	11,139	21,896	33,614	44,523	56,527	67,963	80,918	93,296	105,317	118,490	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,424	3,542	9,674	13,054	15,588	17,931	19,930	21,727	24,371	27,017	Profit Tax
3	Akcizat	3,044	6,139	9,572	12,921	16,627	20,746	24,824	29,714	33,319	37,155	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,437	6,001	8,533	11,422	14,244	17,415	20,868	25,111	27,923	30,945	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,397	6,645	9,338	12,240	15,467	18,538	22,237	25,590	28,890	32,225	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	418	877	1,400	1,867	2,431	2,960	3,550	4,092	4,559	5,091	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,365	2,262	3,564	6,952	8,816	10,915	12,545	14,159	15,585	17,303	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	267	494	820	1,666	2,197	3,075	3,502	3,892	4,224	4,566	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	12	20	183	231	258	268	275	290	296	303	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,087	1,748	2,561	5,055	6,360	7,572	8,768	9,978	11,065	12,435	Local Taxes
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	8,892	15,821	22,761	31,367	38,403	45,777	54,743	62,042	69,326	78,391	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	7,593	13,556	19,505	26,792	32,805	39,109	46,693	52,959	59,217	66,871	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,213	2,093	2,977	4,200	5,103	6,020	7,282	8,214	9,152	10,421	Health insurance
III.	Të ardhura Jotatimore	2,184	4,009	6,514	8,139	10,512	13,058	14,414	15,772	17,205	19,007	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë			900	900	900	900	900	900	900	900	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,656	2,989	4,209	5,268	6,827	8,623	9,475	10,250	11,116	12,234	Income of budgetary institutions
	TOTALI I SHPENZIMEVE	30,028	63,854	100,280	139,869	180,744	215,336	253,619	289,714	325,988	368,555	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	26,464	57,401	89,748	121,547	153,656	184,849	218,085	250,125	281,471	318,437	Current Expenditures
I.1	Personeli	6,018	12,232	18,322	24,343	30,372	36,521	42,706	48,768	54,845	60,839	Personnel expenditures
1	Paga	5,157	10,263	15,454	20,610	25,783	31,058	36,189	41,302	46,448	51,527	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	847	1,667	2,539	3,378	4,244	5,091	5,950	6,790	7,650	8,498	Social insurance contributions
I.2	Interesat	2,997	5,968	8,488	10,865	13,063	15,384	18,131	20,804	23,344	29,710	Interest
1	Të Brendshme	2,305	4,622	6,521	8,304	10,039	11,852	13,961	15,974	17,817	19,748	Domestic
2	Të Huaja	692	1,346	1,967	2,560	3,024	3,532	4,170	4,830	5,527	9,962	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,589	3,901	8,079	11,309	15,136	18,523	22,227	25,439	28,765	32,940	Operational & Maintenance
I.4	Subvencionet	73	174	243	327	421	479	519	567	616	752	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	11,846	24,573	37,632	50,831	64,604	78,233	92,543	107,117	120,927	134,891	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	9,218	18,360	27,987	37,602	47,552	57,908	68,540	79,841	90,394	100,555	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,628	6,214	9,323	12,907	16,181	19,453	22,619	25,893	28,748	32,226	Health insurance
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,935	7,948	12,403	17,554	21,808	25,990	30,353	34,106	38,148	42,640	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,006	2,604	4,581	6,319	8,251	9,721	11,607	13,323	14,828	16,665	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	26	50	75	102	128	157	185	215	244	273	Unemployment insurance benefits
I.8	Transferime Kapitale										139	
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca					0		0				Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	3,564	6,453	10,532	18,322	27,087	30,488	35,534	39,589	44,517	49,979	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	0	1,489	4,862	11,626	16,941	18,876	22,289	23,879	26,821	30,642	Domestically financing
2	Financimi Huaj	3,564	4,964	5,670	6,696	10,146	11,612	13,245	15,710	17,696	19,337	Foreign financed
IV	Detyrimet e prapambetuara											Arrears
V.	DEFICITI	5,363	3,702	5,015	3,286	-735	1,693	2,416	4,084	3,234	1,451	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-5,363	-3,702	-5,015	-3,286	735	-1,693	-2,416	-4,084	-3,234	-1,451	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-8,041	-6,633	-6,671	-198	2,594	1,379	1,955	-871	-162	-33,582	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	29	36	38	39	42	43	45	46	49	68	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	6,031	7,867	11,676	13,992	14,922	18,441	25,342	25,241	29,543	29,440	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-14,100	-14,536	-18,386	-14,230	-12,371	-17,105	-23,432	-26,158	-29,755	-63,090	Others
V.3	I huaj	2,677	2,931	1,656	-3,088	-1,859	-3,071	-4,371	-3,214	-3,071	32,131	Foreign
1	Hua afatgjatë (e marrë)	3,400	4,351	5,065	6,049	8,834	9,079	10,524	12,912	15,654	79,216	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nën-hua		87	106	474	944	1,039	1,034	1,189	1,463	1,424	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	68	288	146	268	82	1,058	949	773	-248	-132	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-791	-1,708	-3,556	-9,404	-10,775	-13,208	-15,844	-16,899	-18,477	-46,953	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

Tabela e investimeve 2018

Table of investments 2018

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	
Financim i brendshëm	- 8,041	- 6,633	- 6,671	- 198	2,594	1,379	1,955	- 871	- 162	- 33,582	Domestic financing
Në %	149.92	179.16	133.02	6.04	353.09	-81.45	-80.90	21.32	5.02	2315.12	In %
Financim i huaj	2,677	2,931	1,656	- 3,088	1,859	- 3,071	4,371	- 3,214	- 3,071	32,131	Foreign financing
Në %	-49.92	-79.16	-33.02	93.96	-253.09	181.45	180.90	78.68	94.98	-2215.12	In %
Totali	-5,363	-3,702	-5,015	-3,286	735	-1,693	-2,416	-4,084	-3,234	-1,451	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

TË ARDHURAT DOGANORE 2018
CUSTOMS REVENUES 2018

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	
